

APLIKIMI PËR LICENSË PËR VEPRIMTARI IMPORT/EKSPORT
Burime radioaktive
Aplikim i ri

- Personi juridik/ fizik: _____
Emri, Mbiemri(përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Tel _____
E-mail _____
Ekstrakti i rregjistrimit në QKB _____

- Të përshkruhen kategoritë e burimeve radioaktive, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me import/eksportin.

- Regullat e brendshme dhe supervizimi. Të paraqitet një informacion mbi funksionimin e brendshëm të subjektit.

Dokumenta për tu ngarkuar në sistem sipas renditjes

1. Rregullore e brendshme mbi menaxhimin e burimeve radioaktive gjatë import/eksportit et
2. Një dokument i veçantë për strukturën organizative.
3. Listën e punëmarrësve
4. Për ruajtjen e përkohëshme ngrakoni licencë për ruajtje dhe trajtim burimesh radioaktive, ose kontratën me një subjekt i cili zotëron një licencë të tillë sipas sqarimit në pikën nr. 1.
5. Dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit sipas sqarimit në pikën nr. 2

Burimet radioaktive nuk duhet të transferohen tek subjekte të cilat nuk disponojnë licensën përkatëse për përdorimin, ruajtjen etj.

Duke mbajtur përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format pdf me ngjyra .

Aplikimi i plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për aplikuesin për licensë. Bazuar në nenin 3 të rregullores Nr. 10 datë 7.01.2010 për licensim dhe inspektim për marrjen e licensës, çdo person juridik dhe fizik aplikon online jo më vonë se 90 ditë pune para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Mbas aplikimit, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licensës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se aplikimi ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Pr. Administrative, afati për shyrqtimin e aplikimit fillon nga paraqitja e plotë e dokumentacionit.

Shënim :

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me Ligjin nr.8025, datë 09.11.1995, i ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.

2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet , Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e aplikimit për licensë
Burime radioaktive
Import-Eksport

Pika 1- Për ruajtjen e përkohëshme të burimeve radioaktive duhet të pajiseni me licensë për ruajtje dhe trajtim burimesh radioaktive, ose duhet të keni një kontratë me një subjekt i cili zotëron një licensë të tillë, ku të sqarohen detyrimet e secilës palë për pranimin dhe kthimin e burimit sipas nevojave.

Pika 2- Paraqit me shkrim mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit për të gjithë burimet radioaktive që importohen/eksportohen, listën e të gjithë subjekteve ku do të transferohen, lejet e import/eksportit të lëshuara nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, ose Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe çertifikatën e cilësisë të burimit radioaktiv.